

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Aq shumë i kishte munguar ajo lanete, Babo e priti Mamicën me lule e çokollata", satira e Gjekmarkajt p ër seancën e fundit të Parlamentit
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/19/ulesia-ngroh-duart-ne-cdo-zjarr-qe-ndizet-sypetrit-mal aj-kishte-ethe-dhe-mornica-satira-e-gjekmarkajt-u-pa-puna-niko-lart-ne-poshte/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 09:56:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 09:52:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 09:51:00 UTC → 19 shtator 2026, 09:53:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e4f4f12667e5a37bb2d1a19567c368034e3088abaedb0c5a48cac82894cd312f
TEKSTI	e1605a5b69fa2b709918db87426cd59fa3f179172e3b5e2aa0d2aaa5b1ad2cc9
PAMJA	fce5955a0d00a39d8ef4e49a53dce478a11835a32c8ed3d2821c517e5c71655d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	18dde11a6fa8844cabd2141439792bab51d8d300cf05899d1718c1ffbb592f1f
E MËPARSHMJA	7a10ebe2e0a957260993ec36d28778db53dcf0f14df421604022fd6003f4f6ed
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/18dde11a6fa8844cabd2141439792bab51d8d300cf05899d1718c1ffb592f1f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE POLITIKË TË FUNDIT

“Aq shumë i kishte munguar ajo lanete, Babo e priti Mamicën me lule e çokollata”, satira e Gjekmarkajt për seancën e fundit të Parlamentit

19/09/2026 11:52



Nga Agron Gjekmarkaj

Kronika bën inventarin, mbledh nektarin dhe shpërndan vrerin!

Pa e marrë mirë veten nga largimi prej qeverisë të një personaliteti poliedrik si Pirro Dëngu, ecja e mendueshme e të cilit dhe vështrimi ndaj horizontit na lanë mbresa të pashlyeshme, si gjëmë në këputi dëbimi i Lameqyqes dhe çmëritja e tij!

Thonë që Etilda atje në konak të Kryeministritë çorri faqet, por shpejt kishte mbledhur veten e i kishte bërë një kafe pa sheqer që të shtrëngonte midenë e mos të zalisej në divanin e Babos sa të mbaronte xhirimi i agjitpropit!

Ministri i ri i Rendit, Demir Demo, ia di kimene ta pësosh nga krimi i organizuar, ndaj do i bëjë luftë të madhe atij!

Gojë të liga, që u shofshin e kripë ngrënshin gjithmonë, thonë që edhe një javë më pas, ngaqë është topolak, i mbetën shenjat e dackave nëpër faqe dhe të shkëlmave në tule, atëherë kur e darovitën në zyrë fshatçe! Janë harbutër, more! Kanë dorë të rëndë, dreqërit!

Tani do ulet afër Gonxhes dhe, si dy mzeter, do tërheqin parmendën e qeverisë! Babua do i cyse pakëz me hosten në të prapme!

Lozonjari Sofjan, me mungesën e gjatë, i ka madhëngjyer disa, natyrisht jo burrat allçak si Termeja!!!

Qefserja rri e pajetë dhe e murosur, askush nuk e di pse është në Qeveri, ajo vetë jo e jo, por as Babo, i cili me gjasë ka dashur të shkaktojë një habi duke dekurajuar kuriozët në zbërthimin e këtij labirinthi logjik!

Klodi Spaqia u vuvos në interpelancën e parë, skuqej, lebetitej, fliste përçarë e ngrata, i jepte urdhra Evis Kushit, përjashtoi atë, largo këtë, sillmë ujë se plasa, lëshonte piskama, kërkonte ndihmë, ikte, vinte, djersitej, uf e buf! Kur doli nga salla, për fat, Pendavia, i merakosur, me një erashkë të madhe i bënte fresk dhe i frynte nga pak që t'i binte ndezullia!!!

Zenikeja, edhe pse mori një kompliment ashtu trashë, le të themi derrçe, për këmbët nga gazetarët apo gardistët, ka një shpërthim nuri, sa Antoneta Dyfeku ka kaluar në hije me bikotinat e veta!

Dilo Nasufi ngjan me Diogjenin. Nufi me një peshëngritës amator!

Tezja po jeton një periudhë rehatie, po gjithsesi, kur doli në foltore, i hoqi tapën faqores, e tërhoqi nia dy herë, një tuuup u dëqia në ajër, një llek, llek, llek e pastaj fshihi buzët dhe

Kryesore



Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

12:08

“Prania Besnike”, zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle

08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze

08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

11:11

Më të lexuarat

Ruga Milot-Balldren/ 365 mln euro nën hijen e SPAK, në konsorciumin fitues edhe emra në hetim nga Prokuroria e Posaçme

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplaslet për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

Putini troket në derën e Evropës me “mjedin” gjerman të ekstremit të djathtë/ Moskë dhe AfD në të njëjtën tryezë për kthimin e gazit rus në Berlin

Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë të plagosur në gjendje kritike

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratiset

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve

5.2 milionë euro dhe një vilë 14 milionëshe/

lëshoi një eh kënaqësie e sigurie!

Tani që kaloi gushtin, sikur nuk i bën dëm si më parë as në kokë, as në stomak!!

Na kënaqi lanetja me shikime të zgjatura, mbushur me habi, mister e qortim, me flokët që i mblidhte topuz me dorë dhe pastaj, si turtulleshe adoleshente, lëshonte nektar në arat e mërzisë me lëvizjet sensuale të kokës, shoqëruar me pulitje qerpikësh, ku delikatesa dhe sharmi bashkoheshin në një, krejt si proshuta e djathi në panine!

Klosi i kishte sytë kapuç! Ulesia ngroh duart në çdo zjarr që ndizet, kafshonte buzët që në sabah dhe bënte shenja e shiharete! Nën zë tha: aman, mos e ngacmoni, e ka gdhirë mbrëmë, lëreni aman, ka humbur shumë, por xhani i donte të kundërtën.

Fatmir Xhafa, nëna e reformës në drejtësi sipas Starzimitit, se babe kishte caktuar Aurela Anastasin si një dollibash pa shishe, përpiquej t'u mbushte gotën edhe magjistratëve, edhe qeverisë!

Sypetrit Malaj kishte ethe dhe mornica gjithë kohën! Delina Brahimi i vinte një pecë të lagur me ufuth, herë pas here, te koka dhe fap i raste një aspirine në gojë!

Lajmi që Mamica ka takuar Babon e thirrur prej tij në zyrë, e shoqëruar nga Tao si dëshmitar, por dhe si lajmës që llafi të përhapej me masë, e ka ndryshuar qamet situatën!

Thonë që Babos, për herë të parë, i është lagur e qullur mjekrra nga malli, aq shumë i kishte munguar ajo lanete! E kishte pritur Mamicën me lule e çokollata!

Teksa Mamica fliste, ai i kishte bërë edhe një portret, ku flokët ia kishte nakatosur si litarë e nyje ku të mbetet shpirti i varur!

Socialistët prisnin në radhë tani për të pirë një kafe me Mamicën, por ajo zgjodhi "Kronikën", që e ka mëkuar, mbajtur si në gji të Krishtit e mbrojtur nga syri i keq në këto kohë jallane!

Vetë Bledion Nallbaja, me të marrë lajmin, i kishte dhënë fund eremitizmit!

Ai kishte ndezur zjarrin në gji, ndaj filloi përsëri poteren, zallamahinë kundër qeverisë! I zhgënjyer, pasi kishte shpresuar që Mamica do ndahej nga tufa dhe ai, si ujë i vjetër, do bënte kërdi, tani ndjellte hatane!

Ervin Hoxhes i eci mbarë, më në fund u kujtuan për atë çamarrok e caktuan në grupin e miqësisë me Korenë e Veriut! Habëri shkaktoi të qeshura, por ai ishte i emocionuar dhe e mori si shenjë ringjalljeje! Qesh mirë kush qesh i fundit, u mejtua!

Pritet që Damon ta caktojë në atë të Jemenit!

Bora ka rënë në të thella, bashkë me Iglin bëjnë muhabete mistike për temjanin, djallin e të birin! Ngjajnë si dy klerikë të braktisur nga Kisha!

Olta dhe Ogi i janë rikthyer vetëdijes popullore, tabanit, meditojnë dhe shohin filxhan!

Kryezevend Lideri Hyqymeti Flamur, gjithnjë e më serioz e hijerëndë, siç i ka hije, qortoi "Kronikën" për hallakatje, dalje nga tema politike e ditës dhe mesazh të shpërqendruar! Mbajtëm shënim dhe i thamë aferim! Duart i këpusim, qejfin nuk ia prishim.

Aty nga pasditja, meqenëse protestuesit na kishin bllokuar furnizimet me byrek e llallë që drejtorja e shërbimeve na i shet katër herë më shtrenjtë se tregu, Tao kishte uri çakalli!

Erjo Mile, emri i të cilit u fiksua pas një viti si një akçi i mbaruar, ia gjeti anën e solli tre shporta plot me sallam, shishqebap, djathë, qepë e copa kukureci! I hapën aty në mes të vendit!

Erjon Malajt, hamesit, i lexohej padurimi dhe nepsi, ndërkohë mbante një thupër që të gjuante Erjon Braçen, i cili kërkonte një çaçkë! Një çaçkë mi një çaçke, po hiç, ata zemrën gur!

Deputetë flisnin, Tao përtypej, i dhanë lugë, pirun, por jo, do ha si populli, tha: mishi e gruaja zihen me dorë!

Të mbushim barkun, rënkoj, u pa puna, Niko lart, ne poshtë, jallane politika!

Brunilda Bakerri e shihte dhe e admironte! Sa fat të jem afër Taos!

Ky është Zhigoloja që u akuzua se mashtroi vejushën e pasur në Manhattan

JPMorgan: Nuk e dimë se si do të përfundojë lufta SHBA-Iran/ Analistët për "The Guardian": Tregu është në ankth për çmimin e naftës

Debati që i ashpër dhe i gjatë!

Gazment Bardhi, i cili kishte pirë benzinë, e bëri Babon të ikte nga salla, se i vogli shtrin viganin, se i shtypuri tiranin, do thoshte Noli!

Mos, mor, haram, mos pshretinte Kostaqi nga lozha, mos, mor, katran, mos, si t'i nxë goja ato lafe, si po ia helmon xhanin para se të niset në Amerikë, ai me besë, me pasqyrë, me krehër, me prani, pra ai me bukë e ju me gurë, sytë ju plaçin, hajër mos bëfshi!

Qershia mbi tortë që Jorushi i Tabakeve, ajo si profeti para mbretit, nën dirigjimin e Saimir Koreshit, këndoi himnin e protestës edhe për faktin se Babua e pa në mënyrë të pahijshme: "Babo, jep dorëheqjen"!

Isuf Çela me Xhelal Mziun pinin nga një duhan si njerëz që kanë parë shumë e më tepër do të shohin! Bujar Leskaj shkund "Kronikën" që të dalë nga dembelia dhe të bëhet më e shpeshtë se mezi e pret mileti!

Top Channel

I Kryesore »



Dyshohen për përvetësimin e 1143 hektarëve tokë përmes dokumenteve të falsifikuara, ish-drejtesit e ASHK-së në Fier dalin para gjykatës

19/09 12:14



Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

19/09 12:08



Incident me armë zjarri në Tiranë, plagoset lehtë një person. Shpallet në kërkim autori i dyshuar

19/09 11:56



Gruda, Adri Mehmeti dhe Kurtulan?/ Trajneri i Kombëtares: Lojtarët e dinë që i duam te Shqipëria, por zgjedhja mbetet në dorën e tyre

19/09 11:27



"Kerjota ka spikatur, mund të na ndihmojë", Maran flet për listën e Kombëtares: Ja pse nuk i ftova Brojën dhe Bajramin, dera mbetet e hapur

19/09 11:11



Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

19/09 11:11

I Politikë »



"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle

19/09 08:26



"Prova të dobëta kundër Thaçit"/ Avokati i ish-presidentit kundërshton gjykatën për vrasjen e Allaqit: Do apelojmë

18/09 20:04



"Askush nuk ju kërkon të ndaloni së fituari", Rama për supermarketet: Do të vihet në funksion 'Pasqyra e Çmimeve', ja çfarë kërkon qeveria nga tregtarët

18/09 15:06



"Vendimi i Gjykatës së Lartë është kafkian", reagojnë avokatët e huaj të Veliajt: Vë në provë nëse kontrolli kushtetues ka funi praktika



U votua gjatë natës dhe u dekretua në mëngjes nga Presidenti, botohet në Fletoren Zyrtare ligji i formulës së re të parave të manistatëve



Dekreti i Presidentit Begaj, Ervin Demo betohet si ministër i ri i Brendshëm

18/09 12:33

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Niveli disproporcional i dënimeve, Joseph: Pa fjalë nga vendimi i Speciales!



Top News – Shqipëria, ekonomi të qëndrueshme. Moody's përmirëson perspektivën në pozitive



Top Channel/ PISA 2025, alarm për arsimin europian, rezultatet bien në nivele historike!



Top Channel/ Festa e dasmës në Bahamas, biznesmeni i lidhur me Kremlinin pagoi qindra mijëra dollarë



Top Channel/ Gjermania "i bie hilesë": Shtërëgon darën ndaj abuzimit me ndihmat sociale!



Top News- Oligarku rus pagoi dasmën e djalit të Trump/ Donald Jr: Nuk kishte motivim politik

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tani!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria